





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Gjilan



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of

Gilan Belediyesi

Bazuar në nenin 12 shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 38 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe 46 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014 i ndryshuar dhe plotësuar me Statutin 01.Nr.016-28448 të datës: 22.03.2018, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 23.02.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

për lirim të përkohshëm nga obligimi i pagesës së gjobës komunale për regjistrime të mëvonshme të lindjes dhe vdekjes

1. LIROHEN qytetarët e Komunës së Gjilanit nga obligimi i pagesës së gjobës komunale për regjistrime të lindjes dhe të vdekjes pas kalimit të afatit ligjor (regjistrime të mëvonshme).
2. Lirimi nga pagesa e gjobës, sipas paragrafit të parë të këtij vendimi, aplikohet për regjistrimet e mëvonshme vetëm gjatë vitit 2023.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Administratës së Përgjithshme Komunale ndërsa mbikqyrjen e tij e bënë Kryetari i Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

01.Nr.016-20432
Gjilan, më 23.02.2023



Kryesuesi i Kuvendit


Arianit Sadiku
/Arianit Sadiku/

A r s y e t i m


Drejtoria për Administratë të Përgjithshme në vazhdimësi pranon kërkesa nga qytetarët për regjistrime të lindjeve dhe vdekjeve pas kalimit të afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh. Në këto raste, sipas Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile si dhe Rregullores (KGJ) Nr. 2/21 për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale është paraparë shqiptimi i gjobave sipas periudhave të caktuara kohore të skadimit të afatit ligjor për regjistrim.

Për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë globale Covid-19, informimit jo të mjaftueshëm të qytetarëve lidhur me shqiptimin e gjobës si dhe kushteve të rënda ekonomike që vështirësojnë kryerjen e këtij obligimi, tanimë evidentohet një numër i konsiderueshëm i rasteve të paregjistruara të lindjeve dhe vdekjeve.

Ky vendim merret me qëllim që brenda një afati gjatë vitit 2023, të regjistrohen lindjet dhe vdekjet të paregjistruara deri më tani duke evituar pagesën e gjobës vetëm gjatë kësaj periudhe si dhe në mënyrë që ky vendim të shërbej si fushatë vetëdijësimi për regjistrimet e tilla brenda afatit ligjor në të ardhmen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština njilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Na osnovu člana 12.d, Zakona br. 03/L-040 za lokalnu samoupravu, član 2.3 Zakona br. 03/L-049 za finansije lokalne samouprave, član 38.1.4 i 46.2.3 Statuta opštine Gnjilane 01 br. 016-126211 od: 06.11.2014. izmenjen i dopunjen Statutom 01 br. 016-28448, od: 22.03.2018, Skupština opštine Gnjilane na sednici održanoj: 23.02.2023, usvojila je sledeću:

ODLUKU

za privremeno oslobađanje od obaveze plaćanja opštinske kazne za naknadne upise rođenja i smrti

1. Građani opštine Gnjilane oslobađaju se obaveze plaćanja opštinske kazne za upis rođenja i smrti nakon isteka zakonskog roka (naknadne upise).
2. Oslobađanje od plaćanja novčane kazne, prema stavu prvom ove odluke, odnosi se na naknadne upise tokom 2023. godine.
3. O sprovođenju odluke staraju se predsednik opštine i Uprava za opštu administraciju u opštini Gnjilane.
4. Odluka stupa na snagu petnaest (15) dana nakon prihvatanja od strane Ministarstva administracije lokalne samouprave i objavljivanja na internet stranici opštine.

01.Br.016-20432
Gnjilane, 23.02.2023



Predsedavajući Skupštine


/Arianit Sadiku/

Obrazloženje

Uprava za opštu administraciju nastavlja da prima zahteve građana za upis rođenih i umrlih nakon isteka zakonskog roka od trideset (30) dana. U ovim slučajevima, prema Zakonu br. 04/L-003 o civilnom statusu, kao i Uredbi (OG) br. 2/21 za opštinske takse, opterećenja i kazne, predviđeno je izricanje novčanih kazni prema određenim vremenskim periodima isteka zakonskog roka za registraciju.

Zbog situacije nastale kao posledica globalne pandemije Covid-19, nedovoljne informisanosti građana o izricanju kazne, kao i teških ekonomskih uslova koji otežavaju ispunjavanje ove obaveze, sada je evidentno značajan broj neprijavljenih slučajeva rođenih i umrlih.

Ova odluka je doneta kako bi se u periodu od 2023. godine upisali rođeni i umrli koji do sada nisu registrovani, izbegavajući plaćanje kazne samo u tom periodu, kao i da ova odluka služi kao kampanja podizanja svesti o takvim upisima u zakonskom roku u budućnosti.